REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2020:043903
Datë: 17.06.2022
Numri i dokumentit: 03145409

C.nr 179/2020

Gjykata Themelore në Pejë Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Bekim Avdimetaj, me procesmbajtësen Yllka Shabanaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit J.R nga Komuna e Deçanit, të cilin e përfaqëson i autorizuari F.K avokat në Pejë, kundër të padituresë Komuna e Deçanit –Drejtoria e Arsimit në Deçan, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi D.P Avokat Publik Komunal, me objekt kontesti Kompensim i shpenzimeve ushqimore, me vlerë të kontestit 1.472.00 euro, gjykata jashtë seance më datë 17.06.2022 mori këtë:

AKTGJYKIM
(PËR SHKAK TË PADEGJUESHMËRISË/MOSBINDJES)

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit J.R nga Komuna e Deçanit, të cilin e përfaqëson i autorizuari F.K avokat në Pejë

DETYROHET e paditura, Komuna e Deçanit –Drejtoria e Arsimit në Deçan, që paditësit në emër të kompensimit të shujtave ditore për 736 ditë pune, prej dt.18.04.2017 e deri me dt.12.11.2021, t'ia paguaj paditësit shumën prej 1.472.00 euro € (njëmijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy euro), me kamatëvonese vjetore prej 8% duke filluar nga dita e përpilimit te aktgjykimit me datën 17.06.2022 deri në pagës e plotë, si dhe **detyrohet** shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 125 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit te këtij aktgjykimi, e nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Paditësi J.R nga Komuna e Deçanit në përmes autorizuarit të tij në këtë gjykatë ka paraqitur padi kundër të padituresë Komuna e Deçanit –Drejtoria e Arsimit në Deçan, për pagesën e shujtave ditore.

Në padi paditësi ka theksuar së e paditura me paditësen duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, në bazë të kësaj kontrate paditësi kërkon që të përmbushet Kontrata Kolektive e Arsimit në atë mënyrë që paditësit ti paguajnë shujtat ditore në shumë prej 2 euro për ditët e punës ashtu që për 736 ditë pune, prej dt.18.04.2017 e deri me dt.12.11.2021, t'ia paguaj paditësit shumën prej 1.472.00 euro € (njëmijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy euro), me kamatëvonese vjetore prej 8% nën kërcenim përmbarimit më dhunë.

2020:043904

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore ka nxjerr aktvendimin për përgjigje në padi dhe precizimin të saj, me datë 08.09.2021 të cilin e paditura e ka pranuar me datë 13.09.2021. Me aktvendimin për përgjigje në padi gjykata e ka njoftuar të padituri n për detyrimin ligjor për dhënie të përgjegjës në padi dhe për pasojat e ligjore që do të ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësin që gjykata të nxjerr aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë. I padituri pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, në këtë çështje juridike kontestuese nuk ka jep përgjigje në padi.

Gjykata në kuadër të autorizimeve ligjore në kuptim të dispozitave nga neni 150 i Ligjit për Procedurën Kontestimore pasi vlerësoi kushte ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të pa dëgjueshmërisë, gjeti së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushte ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë. Gjykata i vlerësoi të gjitha kushte për nxjerrjen e aktgjykimit siç parashohin dispozitat nga neni 150.1 nën (a), (b) dhe (c), dhe atë së të padituri t i është dorëzuar padi dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi, në rastin konkret nga provat e dorëzuar me padi vërtetohet fakti së paditësi është në marrëdhënie të punës me të padituren sipas kontratës me nr.prot.14204-07,e dt. 03.05.2019, si dhe vërtetimin e prezencës ne pune me nr. të protokollit 04-2232/2020 dt.31.08.2020, vërtetimin e prezencës ne pune me nr. të protokollit 04-2795-2021 si dhe lista e pagës..

Gjykata e vërtetojë bazën dhe lartësinë ne bazë të provave të lartë cekura si dhe në bazë të Kontratës Kolektive e Arsimit e dt.18.04.2017 në nenin 35 paragrafi 7 dhe e obligon Komunën e Deçanit –Drejtorin e Arsimit që për shujte ditore t'ia paguaj shumën prej 2 euro çdo ditë të punës, bazë. Gjeti së kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe vendosi si në dispozita të këtij aktgjykimi.

Andaj kuptim te nenit 150,160 pika 6 LPK-së janë dhënë vetëm arsyet që justifikojnë marrjen e këtij aktgjykimi

Lidhur me kamatën ligjore të cilën obligohet ta paguaj e paditura gjykata ka vlerësuar se e njëjta rrjedh për pagesë nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi dhe caktoi lartësinë e saj prej 8% në vit, duke u bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara, i referohen taksës për padi, 21.00 euro si dhe përpilimit të padisë në shumë prej 104.00 euro në total 125.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr 179/2020 17.06.2022

Gjyqtari,
Bekim Avdimetaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.